

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA ZYRA E KRYEMINISTRI - UREDI PREMIERA - OFFICE OF THE PRIME MINISTER SEKTORI I ARKIVËS - SEKTOR ARCHIVE - ARCHIVE SECTOR	
Nr. Pro. Org. Unit	02-1-a
Nr. Pro. Pro. Nr.	1564/3
Nr. f. faqe Br. stranica No. pages	-2-
Data: Datum: Date:	22 / 08 / 2023
Prishtinë/a	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

**Datë: 22.08.2023**

Mbledhja e 156 e Qeverisë e Republikës së Kosovës mbahet më 23.08.2023, në orën 11:00, ndërtesa e Qeverisë, salla P-31.

**RENDI I DITËS**

1. Aprovimi i ekstrakteve të procesverbaleve dhe transkripteve nga mbledhjet: 148, 149 dhe 151 dhe ekstrakteve të procesverbaleve nga mbledhjet: 150 dhe 152 elektronike/korresponduese të Qeverisë së Republikës së Kosovës (ZKM)
2. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për aprovimin në parim të certifikatave pjesëmarrëse të Republikës së Kosovës në Bankën Zhvillimore të Këshillit të Evropës dhe pagesën e kapitalit (MFPT)
3. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndarjen e mjeteve buxhetore për zbatimin e masës 1.3 - Mbështetja e Punësimit të Grave dhe Masës 5 - Investimi në Infrastrukturë dhe Ambient të Pakos së Ringjalljes Ekonomike (MFPT)
4. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për rialokimin e mjeteve në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në 29 (njëzet e nëntë) projekte kapitale në përputhje me memorandumet e mirëkuptimit për projekte kapitale të nënshkruara nga Ministri i MMPHI-së dhe Kryetarët e Komunave (MMPHI)
5. Shqyrtimi i Propozim-vendimit Përfundimtar për shpronësim për interes publik i pronave të paluajtshme të cilat janë të nevojshme për realizimin e "Projekteve Infrastrukturore për Interes Publik", në Komunën e Leposaviqit dhe Komunën e Zubin Potokut (MMPHI)
6. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për shqyrtimin e mëtejme të kërkesës për shpalljen e zonës së mbrojtur ujore për qëllime strategjike me interes publik të ndërtimit të digës sipas projektit "Hidrosistemi Iber-Lepenc Faza I", për nevoja të Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës, brenda zonës me koordinata prej 1 deri në 35, Komuna Shtërpçës (MMPHI)
7. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për t'i propozuar Kuvendit të Republikës së Kosovës kandidatët për pozitat e 2 (dy) anëtarëve të Komisionit të Autoritetit të Konkurrencës (ZKM)
8. Shqyrtimi i Draftit të Koncept-dokumentit për Kodin e Procedurës Civile (MD)
9. Shqyrtimi i Draftit të Koncept-dokumentit për Gjykatën Administrative dhe të Punës (MD)

10. Shqyrtimi i Draftit të Koncept-dokumentit për Rregullimin e Fushës së Punësimit (MFPT)
11. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit të Qeverisë Nr. 28/99 të datës 30 shtator 2022 (ZKM)
12. Shqyrtimi i Projektligjit për Aderimin e Republikës së Kosovës në Konventën për Importin e Përkohshëm (MFPT)
13. Informimi i Kabinetit Qeveritar mbi zbatimin e Programit Kombëtar për Integrim Evropian për periudhën janar qershor 2023 (ZKM)
14. Të ndryshme